RILINDASI
Suplement i SHQIPTARJA.com


E diel
5 korik 2015
Viti IV - Nr:78
E-mail: rilindasi@gmail.com
Kryeredaktore;
Admirina Peçi


YLLI I DAVIDIT

Ç'kuptim ka simboli i gjetur në një stelë varri në Korçë

NGA DRITAN ÇOKU

Gjatë muajt maj të këtij viti realizuam disa vizita në muzeumet e qytetit të Korçës, një prej të cilëve edhe atij Arkeologjik. Në këtë guidë na shoqëronte ish drejtori i këtij institucioni Skënder Aliu (punuar në vitet 1999-2005), ekspert i arkeologjisë prehistorike i vendit tonë, i cili luante dhe rolin e shpjeguesit. Në oborrin e banesës me çardak kur pak kohë më parë ky objekt me një arkitekturë të spikatur dhe me një trajtim të veçantë të elementëve arkitektonik ka qenë muze Arkeologjik, përveç ekspozimit të fragmenteve të ndryshme arkitektonike në murin e brendshëm të oborrit ndodheshin të mbështetura edhe dy stela funerare, që prej simbolikës së përdorur na tërheqin vëmëndjen duke u bërë shkak për këtë studim konkret. Sipas Skënder







Aliut 10 vjet më parë në kohën kur ishte drejtor i muzeut, pas një informimi që mori nga banorët e fshatit Gjergjevicë të Korçës për dëmtimin e një varri të vjetër menjëherë shkon në vend përkujdeset dhe i vendos të dy stelat e të njëjtit varr në këtë muze. Stela e kreut në vendosje dhe ajo fundore janë prej guri monolit me ngjyrë të hirtë, të zbukuruar me simbole dhe gdhendur me thellim një datim. Siç na informon Aliu këto ishin të vetmet element funerar të zbukuruara me simbole a motive dekorative në rreth 30 varre në atë varrezë e cila ndodhet në pjesën e sipërme të fshatit Gjergjevicë.

PËRSHKRIMI I STELAVE TË VARRIT

Stela me lartësi 100 cm që qëndron në krye të varrit (fig.1a) në pjesën e sipërme ka formë rrethore dhe më pas zgjatet me linja të drejta....

vijon në faqen 18-19

"Pasqyra e t'rrëfyemit", hidhet në treg revista e re

Titulli "Pasqyra e t'rrëfyemit", një marrëdhënie metaforike me praninë e veprës së Budit. Drejtori i Qendrës "Pjetër Budi", Behar Gjoka, rrëfen se revista e re do të vijojë të jetë një dritare e mendimit pro dhe kundër

NGA DHURATA HAMZAI

Unë nuk pajtohem me ato që keni për të thënë, por do ta mbrojë deri në vdekje të drejtën tuaj për ta thënë atë". *Volter*

Kjo është motoja e revistës "Pasqyra e t'rrëfyemit", numri i parë i së cilës sapo është hedhur në treg nga Qendra Shqiptare e Studimeve Letrare "Pjetër Budi". Drejtori i kësaj qendre, Behar Gjoka, shprehet për "Shqiptarja.com" se "krahas formave të tjera të komunikimit, si të konferencave, tryezave, sesioneve shkencore, si dhe faqes së ëeb-it, QSHSL "Pjetër Budi" pajiset edhe organin .....

faqe 24



Musolini: "Kolegu im i dashur"

Çfarë kujtin George Seldes nga takimet më Musolinin, nga ato çfarë kishte konstatuar në vitet kyç të karrierës së Duçes, makinacioneve e tij politike, etj... Shkëputur nga libri i George Seldes "Dëshmitari i një shekulli", me perkthim nga Meri Lalaj...

NGA GEORGE SELDES

faqe 22-23

Frederik Rreshpja, Poeti që e mbyllin jetën në një libër...

Ai është i vetmi poet i brezit të tij që nuk ka tentuar asnjëherë për të ribotuar në vitet '90-të pjesën e parë të krijimtarisë së tij, por ajo periudhë e krijimtarisë i ka shërbyer si "fletore ushtrimesh"

NGA DR. GAZMEND KRASNIQI

Rënia e funksionales dhe funksioni i modeleve të tjera

Frederik Rreshpja, në pamje të parë, mund të duket një poet jashtë rrjedhave. Ky mendim krijohet duke parë botimet e dy dekadave të fundit, mirëpo, po t'u hedhësh një sy librave të rinisë së tij, kuptohet se sa e rëndësishme ka qenë për këtë poet krijimtaria poetike e Ismail Kadaresë, edhe pse tregonte një talent të veçantë në shumë drejtime. Duhet thënë se shumë motive dhe qasje ndaj tyre të kujtojnë poezitë dhe qasjet poetike të atij që shihej ....


faqe 20-21

GJURMË | E GJURMIME

VULA E SOLOMONIT

Ja ku e kanë nënshkruan mjeshtrit oparakë të gurit

Kush e përdori dhe ç'kuptim ka simboli i Yllit të Davidit, i identifikuar së fundmi në një stelë varri në fshatit Gjergjevicë në Korçë? I njëjti simbol në ndërtime të tjera në Shqipëri ku kanë punuar mjeshtrit e gurit nga Opari…



Simboli i Yllit të Davidit shoqëruar nga simboli Fleur de Lys në hyrjen e Teqesë së Helvetive

NGA DRITAN ÇOKU

vijon nga faqja 17

.....Në gjithë perimetrin e saj përveç pjesës që futet në tokë i është punuar një shirit 3 cm i gjerë. Pjesë të këtij shiriti të punuar edhe horizontalisht në gjerësinë e stelës e ndajnë atë në tri pjesë. Në perimetrin e pjesës së sipërme është punuar me thellim të ulët një linjë e dhëmbëzuar si dhe simboli i Yllit të Davidit i vendosur në qendër të fushës ku skajet e gjashtë cepave të tij shoqërohen nga simboli Fleur de Lys (zambaku). Në pjesën qëndrore të stelës nga punimi në fushë është krijuar një katërkëndor. Sipërfaqja e brendshme e tij është punuar me thellim të lartë dhe përfundon në formën e një trapezi ku në të është gdhendur viti i vdekjes 1310 H (1892-1893). Në mesin e pjesës së tretë është punuar një rozetë brenda së cilës një lule me 12 petale.


Në dallim nga stela tjetër, pjesa e sipërme e kësaj stele (fig.1b) që qendron tek këmbët vjen me kulm. Lartësia është e njëjtë si e para, gjithashtu dhe shiriti i punuar në perimetrin e saj. Një të tretën e stelës e ndan një shirit tjetër horizontalisht dhe dy të tjerë krijojnë një trekëndor në pjesën e poshtme. Në pjesën e sipërme të kësaj stele krijohet një fushë ku perimetri i saj është zbukuruar me zig-zake të futura në mes të dy vijëzave paralele dhe në mesin e fushës është punuar simboli i gjysmëhënës dhe i yllit me pesë cepa. Me sa duket personi që ka ndërruar jetë ka qenë i besimit mysliman dhe kjo jo vetëm prej faktit të simbolikës, por stelat në varret myslimane janë dy, njëra vihet tek koka dhe është ajo që mban mbishkrimin me datat e lindjes dhe vdekjes, dhe stela tjetër tek këmbët e cila është më e thjeshtë për nga forma dhe nuk ka mbishkrime. [1]

MJESHTRAT OPARAK: MËNYRA E ORGANIZIMIT & E FOLURA E TYRE E FSHEHTË


Gurit formë, drurit jetë. – Kjo është një shprehje që përdorej në Opar. Dhe jo pa shkak. Opari është prej krahinave më të njohura të Shqipërisë dhe të Ballkanit për mjeshtrinë e ndërtimeve. [2] Oparakët kanë përdorur çekanin (tokmakun), smilarin (hekur me majë i kalitur tek kovaçi) dhe daltën për të gdhendur gurin duke i dhënë atij formë. Të gjitha veglat kishin përdorim të caktuar. Smilari përdorej për të gdhendur, ndërsa dalta për gonenë e qoshes. Por, një vegël tjetër përdorej për zbukurimin e qoshes e cila quhej matraka.

Në Berat shtëpitë e lagjes kala dhe në përgjithësi ato të lagjeve të tjera, ndërtoheshin nga oparakët. Këto ndërtonin themelet, bënin muret dhe çatmanë, kurse punimet e tjera si dyert, dritaret, tavanet, dyshemetë etj., i bënin ustallarët vendas të Shpiragut. Oparakët vinin në vjeshtë dhe punonin deri në prag të verën, kur largoheshin për në shtëpitë e tyre për të ardhur përsëri në vjeshtën tjetër. Ata vinin në grupe të vogla të përbëra nga 15-20 ustallarë, duke pasur në krye një mjeshtër që i drejtonte punimet dhe bënte marrëveshje me pronarët e interesuar. [3] Ishte bërë traditë që në vjeshtë, muratorë nga fshatrat e Oparit të Sipërm, nga Lekasi, Tudasi, Marjani, Shkozanji, Gjonbabasi etj., të organizuar në grupe sipas shoqërisë e miqësisë, shkonin në zonat e ngrohta, në Myzeqe, në Berat, Vlorë, Durrës për të ndërtuar shtëpi e objekte të tjera. Qëndronin aty për të punuar tërë dimrin, gati gjashtë muaj dhe pastaj ktheheshin në shtëpitë e tyre për t'u marrë me punët e pranverës, më pak me bujqësi e blegtori që kishin. Të njëjtën gjë bënin edhe marangozët e suvaxhinjtë që ishin kryesisht nga Opari i Poshtëm, nga Lavdari, Misrasi, Osoja, Kucaka, Karabanjozi etj. [4]

Përgjithësisht fshatrat që ushtronin mjeshtrinë e ndërtimit si dhe mjeshtritë e tjera ishin të krishtera. Përjashtim bëjnë fshatrat e Oparit, të cilat, edhe pse ishin islamizuar, vazhdonin të ushtronin mjeshtrinë e muratorit dhe të ndërtimit të kalldrëmeve. Për këto fshatra karakteristikë qe ndarja e punës: të krishterët ishin marangozë ndërsa myslimanët ishin muratorë. [5] Në brendësi të grupit, mjeshtrat shpesh përdornin një të folur të fshehtë. Ajo ishte purishtja [6], e folura midis mjeshtrave oparakë. Një lloj komunikimi ku gjatë kryerjes së aktivitetit të muratorisë,



Stelat e varrit në fshatin Gjergjevicë të Korçës




Datimi i rindërtimit të Teqesë së Helvetive


Datim në frizin e mafilit në xhaminë Mbret

mjeshtrat si me njëri-tjetrin ashtu edhe me baltaxhinjtë e tyre të cilët mësonin zanatin në këto përvoja ndërtimore nuk kuptoheshin, sidomos në rastet kur të pranishëm ishin edhe porositësit, pra pronarët e objektit të cilin do të ndërtonin. Kishte raste kur mjeshtri tërhiqte vëmëndjen për realizimin sa më të mirë të muraturës së gurit! P.sh., në purisht: "Se ke rir gruth skoron", pra "se ke bërë mirë murin".

SIMBOLI: KUSH E PËRDORTE & Ç'KUPTIM KISHTE ...?!

Për të kuptuar vazhdimësinë e arkitekturës së qytetit të vjetër të Beratit, janë kryer hulumtime në Berat, Elbasan dhe Opar nga Fatbardha Shkupi duke arritur në përfundimin se Berati barte vlerën e madhe të truallit ku kryqëzoheshin tri stile kryesore të ndërtimit shqiptar, Dibrës, Beratit dhe Korçës.

Pas largimit të mjeshtrave beratas në drejtim të Turqisë, pashai i Beratit Ahmet Kurt Pasha një dashurues i veprave të arkitekturës dhe artit iu drejtua mjeshtërve të shquar kolonjarë dhe oparakë.

Në fillim u ndërtua pallati i sundimtarit, prej të cilit ka mbetur porta e madhe, vepër e gjyshit të usta Naum Ngjelës e skalitur sipas stilit të ikonobartësit të Perondisë, që ngjan me simotrat e veta të shek. 18 në Voskopojë, Vithkuq, Kolonjë e Bregdet. Pas pallatit pashai urdhëroi rindërtimin e Teqesë së Xhelvetive e për këtë qëllim thirri usta Dush Barkën nga Misrasi i Oparit. Ai sipas të dhënave gojore të kësaj zone, veç rikonstruksionit të Teqesë së Xhelvetive kryer me 1782-1783 (fig.2), skaliti motivet e gurta mbi fasadë, pjesët e drunjta dhe stalagtitet e mihrabit, të afërta me stalagtitet e shek. 16 në gjithë Shqipërinë, (të tilla shihen edhe në xhaminë e Plumbit në Berat). Ky usta kreu më vonë dhe rindërtimin e hajatit të xhamisë "Mbret". [7] Siç kuptohet dhe nga mbishkrimi që ruhet i pikturuar në strukturat e mafilit (fig.3), xhamia, në vitin 1248 H (1832-1833) ka pasur një rindërtim të rëndësishëm nga që ishte në rrezik shembjeje. Sipas mbishkrimit, në atë kohë janë kryer ristrukturimi dhe zbukurimi i sallës, rindërtimi i mihrabit dhe minberit, si dhe punime të tjera që nuk përcaktohen dot.[8] Fatbardha Shkupi 25-vjet më parë evidenton të njëjtën vulë të Salomonit, që përsëritet në këto dy objekte (fig.4 & 5), mbi murin e një kulle në Gjonbabas të Oparit, që sipas kodeve sekrete të mjeshtërve është zgjedhur si firmë e grupit të punës [9], por të njëjtin simbol ne e gjetëm edhe në stelën e varrit e vitit 1310 H (1892-1893) e fshatit Gjergjevicë të Korçës.

TRADITA E BREZAVE

Me kohë ushtrimi i mjeshtrive të ndryshme u ngulitën në traditën e popullit, duke u trashëguar brez pas brezi. Duke vepruar kështu vit për vit e brez pas brezi kur babai merrte me vete të birin vëllanë, kushëririn dhe punonin sëbashku, duke mësuar nga njëri-tjetri u krijua një traditë e mirë e u grumbullua një përvojë e pasur dhe nga kjo dolën mjeshtër të vërtetë që arritën kulmet e profesionit dhe ndërtuan vepra të shkëlqyera arkitektonike jo vetëm këtu për Shqipërinë, por edhe jashtë vendit.

Shumë shtëpi të njohura në Berat, Vlorë e Kaninë, shumë kisha të Myzeqesë, në Fier e Lushnje shumë ura në rrethin e Durrësit e ndërtime të tjera janë vepër e mjeshtrave oparakë, mbajnë firmën, vulën e djersës, mundin e talentin e tyre të fuqishëm. [10] Ashtu si Naum Ngjela nga Lavdari i Oparit, ku la emrin, punën dhe talentin e tij sidomos në kishat e Beratit, pas vdekjes së tij, sipas traditës së brezave punën e tij e vazhdoi i biri Mandi që më shumë njihej me emrin usta Mandushi. Ai u dallua për mjeshtrinë e tij si marangoz dhe si sipërmarës në Berat e gjetkë po kështu edhe niprit e usta Naumit dhe djemtë e Mandushit Kristoja, Naumi etj. [11]

Kjo traditë e brezave ka reflektuar edhe në vazhdimësinë e përdorimit të këtij simboli të cilin e hasëm sëfundmi në këtë përmendore mbivarrore, tashmë me një funksion identifikues. Megjithatë, disa mund të jenë dyshues dhe skeptik për identitetin e këtij varri pa emër. Po ç'rëndësi ka? Mjafton të themi se kjo arkitekturë funerare i përket një pure (mjeshtër ndërtimi), që me çekanin e tij ka bërë gurin të flasë.


Simboli i Yllit të Davidit shoqëruar nga simboli Fleur de Lys në hyrjen veriore të xhamisë Mbret

BIBLIOGRAFIA

1- Maks Velo, Studim mbi elemente të arkitekturës funerale myslimane në Shqipërinë e Mesme, "Monumentet" 1992-1999, Tiranë: Aksion 2000, 2001, f.150

2- Apostol Bitraku, Rreth e rrotull në Opar, Vite, njerëz, ngjarje, Tiranë: Argeta – LMG, 2010, f.39

3- Zija Shkodra, Qyteti shqiptar gjatë rilindjes kombëtare, Tiranë: Mihal Duri, 1984, f.434

4- Apostol Bitraku, Rreth e rrotull në Opar, Vite, njerëz, ngjarje, Tiranë: Argeta – LMG, 2010, f.40

5- Pirro Thomo, Korça urbanistika dhe arkitektura, Tiranë, 1988, f.184

6- Eqrem Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. 2002, f.433

7- Fatbardha Shkupi, Mjeshtrat popullorë në Berat gjatë shekujve 18-19 dhe fillimit të shek.20, Monumentet 2/1990, Tiranë: GRAFIKA ARS, 1990, f.57

8- Aleksandër Meksi, Arkitektura e xhamive të Shqipërisë (shekujt XV-XIX), Tiranë: UEGEN, 2007, f.113-114, 117 dhe Gjergj Frashëri, Sulejman Dashi, Fillimet e artit islamik në qytetin e Beratit, 1/1988, (35), f.110-111

9- Fatbardha Shkupi, Mjeshtrat popullorë në Berat gjatë shekujve 18-19 dhe fillimit të shek.20, Monumentet 2/1990, Tiranë: GRAFIKA ARS, 1990, f.57

10- Apostol Bitraku, Rreth e rrotull në Opar, Vite, njerëz, ngjarje, Tiranë: Argeta – LMG, 2010, f. 40-41

11- Po aty, f. 52-53